



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E HARTIMIT TE PROJEKTEVE, MONITORIMIT TE INVESTIMEVE DHE**  
**SHERBIMEVE**

**RELACION**

**Objekti: Rehabilitim I shtresave të mbuleses se Pallatit te Kultures**

- Gjendja ekzistuese

Pallati i kultures Patos ndodhet ne qender te qytetit te Patosit. Ne godinen e Pallatit te kultures jane disa institucione ne varresi te Bashkise Patos te cilat ushtrojne aktivitetit e tyre social kulturor. Godina eshte ndertuar rreth viteve 1970 dhe prej asaj kohe jane kryer investime te vogla qe kryesish kane konsistuar ne mirembajtjen e ketyre ambientve por edhe ne eliminimin e difekteve te ndyshme te dala me kalimin e kohes. Aktualisht gjendja e shtreses hidroizoluese ne tarracen e pallati te kultures eshte e demtuar per shkak te periudhes se gjate qe me ndertimin e tyre dhe ne vazhdim. Kemi demtime ne hidroizolimn e shtresave te salles se sshfaqjeve, sallan e bibliotekes, sallat e mbledhjeve, ne hollet dhe ne shkallet e ketij institucioni. Duke vleresuar shkallen e ketyre demtimeve grupi i punes hartoi projektin per nje nderhyrje emergjente ne te gjitha nivelet e tarraces se Pallatit te Kultures.

- Pershkrimi i projektit

Pas marrjes se detyres se projektimit per rikonstruksionin e te gjitha niveleve te tarraces se pallatit te kultures, grupi I punes vleresoi gjendjen dhe hartoi projekt preventivin e kesaj nderhyrjeje.

Ne projektin e hartuar jane parashikuar heqja e te gjitha shtresave ekzistuese te tarreaces se pallatit te kultures dhe ndertimi I shtresave te reja te termoizolimit dhe te hidroizolimit te kesaj tarrace. Ne projekt eshte parashikuar ndertimi I nje shtrese termoizoluese me trashesi mesatare  $t=10$  cm e cila do tesherbeje edhe per termoizolimn e objektit por edhe per drejtimin e ujrave te shiut drejt pikave te shkarkimit (kasetave shimbledhese) per ne ulluket vertikale. Mbi kete shtrese do te vendoset nje shtrese me lluster cimentoje me trashesi  $t=2$  cm per lidhjen e shtreses termoizoluese dhe hidroizolimit te objektit. Neper bashkimin e soletes me parapetin vertikal te kufizimit te pjeseve te tarraces sipas niveleve ekzistuese do te behet rakordimi I ketij bashkimi sipas detajit te dhene ne projekt.

Shtresa hidroizoluese e objekti do te jete e perbere nga dy shtresa ku shtresa e sipërme duhet te jete e granular dhe pingul me drejtimin e kullimit te ujrave. Trashesia e letres se guajnes (Kartoni katrama) do te jete  $t=4\text{mm}$  dhe ne perberje do te kete fije poliestre per perforcimin e saj.

Ulluket vertikale te shkarkimit te ujrave te shiut dhe kasetat shimbledhese do te jene me material alumin me trashesi  $t=0.6-0.8\text{ mm}$ , i lyer me boje. Ulluke vertikale do te fiksohen me rozetat fiksuese ne muret e objektit.

Per pjesen e brendeshme te parapeteve te niveleve te ndryshme te tarraces do te vendosen impluvert llamarine me gjeresi  $b=30\text{ cm}$  per eliminimin e furjes se ujit ne pjesen fundore te bashkimit te guajnes me parapetin vertikal.

Tegjitha materialet qe do te dalin nga prishja e shtresave aktuale te hidroizolimit dhe termoizolimit te parashikuara per tu prishur do te largohen nga objekti dhe do te depozitohen ne venddepozitimin e mbetjeve te ngurta te percaktuar nga ana Bashkise Patos.

Te gjitha punimet do ti permbahen kushteve teknike te zbatimit dhe per cdo paqartesi ne lidhje me zbatimin e ketyre punimeve firma sipermarese do ti drejtohet grupit te projektimit.

**Punoi:**

Ing. Silvana Mici

Ing. Arben Manoku